



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry Of Environment, Spatial Planning And Infrastructure



AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS
KOSOVSKA AGENCIJA ZA ZAŠTITU SREDINE
KOSOVO ENVIRONMENTAL PROTECTION AGENCY

RAPORT I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

RAPORT I MENAXHIMIT TË MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

VITI RAPORTUES 2020



Prishtinë, 2022

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	1
SHKURTESAT	2
LISTA E TABELAVE, FIGURAVE DHE HARTAVE	3
1.0 HYRJE.....	4
1.1. Qëllimi i raportit.....	4
1.2. Fushëveprimi i raportit.....	5
1.3. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave	5
2.0 Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë	6
3.0 MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË.....	7
3.1. Gjendja aktuale.....	7
3.2. Gjenerimi i mbeturinave komunale.....	8
3.3. Deponimi i mbeturinave komunale.....	12
3.4. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale.....	13
3.5. Faturimi dhe Arkëtimi.....	18
3.6. Deponitë ilegale	23
3.7. Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave komunale.....	26
3.8. Sistemet e ndara për mbeturinat e veçanta.....	27
3.9. Ndarja e mbeturinave-Riciklimi.....	29
3.10. Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave	30
3.11. Operatorët e licencuar për menaxhim të mbeturinave	33
GJETJET E RAPORTIT	35
REKOMANDIMET.....	36
REFERENCAT	37
SHTOJCAT	

SHKURTESAT

MMPHI	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
AMMK	Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
BE	Bashkimi Evropian
GIZ	Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
JICA	Agjencia Japoneze për Bashkëpunim Ndërkombëtar
UA	Udhëzimet Administrative
AKK	Asociacioni i Komunave të Kosovës
MK	Mbeturinat Komunale
MV	Mbeturinat e Vëllimshme
N&D	Ndërtimi dhe Demolimi
MKo	Mbeturina komerciale
LM	Ligji për Mbeturinat
LMM	Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit
PKMM	Plani Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave
PAMKOS	Shoqata e Ndërmarrjeve të Kosovës për Mbeturina
PRKMM	Plani i Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
RrKMB	Rregullorja Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave
DR	Deponi Rajonale
KRM	Kompani Rajonale e Mbeturinave
KP	Kompanitë Private
ASK	Agjencia e Statistikave të Kosovës
SRKMM	Strategjia e Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave
KMDK	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë



Lista e tabelave, figurave dhe hartave

- Tabela 1.** Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara 2020;
- Tabela 2.** Sasia e MK të deponuara/shprehur në ton;
- Tabela 3.** Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2019&2020);
- Tabela 4.** Faturimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020);
- Tabela 5.** Shkalla (%) e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020);
- Tabela 6.** Deponitë ilegale sipas fraksioneve të mbeturinave, (Prill 2021);
- Tabela 7.** Deponitë ilegale sipas madhësisë në rajone, (Qershor 2021);
- Tabela 8.** Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave, 2020;
- Tabela.9.** Sitemet e ndara për mbeturina të veçanta;
- Tabela 10.** Operatorët e licencuar për menaxhim të MK;
-
- Figura 1.** Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2019 &2020);
- Figura 2.** Trendi i deponimit të mbeturinave komunale;
- Figura 3.** Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK nga ekonomitë familjare sipas komunave,(2019&2020);
- Figura 4.** Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas rajoneve dhe në nivel vendi, (2019&2020);
- Figura 5.** Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare në rajone dhe në nivel vendi (2019&2020);
- Figura 6.** Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas komunave, (2019&2020);
- Figura 7.** Deponitë ilegale sipas fraksioneve në nivel vendi (%);
- Figura 8.** Numri i deponive ilegale sipas madhësisë në nivel vendi;
- Figura 9.** Niveli (%) i plotësimit të proceseve të kërkuara në nivel vendi, (2019&2020);
-
- Harta 1.** Gjenerimi i MK në komuna shprehur në kg/banor/vit (2019&2020);
- Harta 2.** Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK sipas komunave, (2019&2020);
- Harta 3.** Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019&2020);
- Harta 4.** Deponitë ilegale sipas komunave, (qershor 2020);

HYRJE

1.1. Qëllimi i raportit

Përgatitja e raportit për gjendjen e menaxhimit të mbeturinave komunale në Kosovë është përgjegjësi direkte Agjencisë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (Ligji për Mbeturinat, neni 14, paragrafi 1.8). Përmes këtij raporti është synohet që të sigurohet një bazë të fortë dhe gjithëpërfshirëse e njohurive mbi menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë. Të dhënat e prezantuara në këtë raport, qoftë për komuna individualisht apo edhe në nivel të rajoneve, japin një pasqyrë të qartë të gjendjes së menaxhimit të mbeturinave, trendeve, problemeve dhe planifikimeve për të ardhmen.

Të dhënat e ofruara në raport do të mund të përdoren për të orientuar politikatat e menaxhimit të mbeturinave komunale qoftë nga niveli i qeverisjes qendrorë, e sidomos nga ai i qeverisjes lokale në kuptim të planifikimit më të mirë dhe më të realizueshëm.

Me miratimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (2021-2030) dhe Planit të Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (2021-2023), është planifikuar një qasje më e përshpejtuar e realizimit të objektivave strategjik, që do të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në aspektin e përmirësimit ekonomik dhe standardit jetësorë. Këta objektiva janë menduar në kuptimin e zhvillimit dhe përmirësimit të shërbimeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të integruar të mbeturinave, rritjen dhe avancimin e sektorit të riciklimit të mbeturinave, rritjen e kontrollit të përgjegjësive dhe zbatimit si dhe promovimin e praktikave më të mira dhe rëndësisë që ka ekonomia qarkore.

Në nivel të komunave, po ashtu ka një qasje inkurajuese sa i përket renditjes së prioriteteve në politikatat e tyre mjedisore, ku menaxhimi i mbeturinave vërehet se ka një fokus më të veçantë. Një numër i komunave i kanë rishikuar planet komunale të menaxhimit të mbeturinave, një numër tjetër janë në pritje të rishikimit për shkak të skadimit të afatit 5 vjeçar. Janë shënuar përmirësime në eliminimin e deponive ilegale dhe trendi është pozitiv. Ka një aktivitet të shtuar në rritjen e ofrimit të shërbimit për qytetarët dhe klientët tjerë, dhe një gatishmëri të madhe nga ana e komunave që duke pasur parasysh edhe mundësitë financiare, të futen në realizimin e projekteve të ndryshme, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në këtë fushë.

Duhet cekur se në këtë raport janë prezantuar të dhëna për 36 komuna të vendit, krejt kjo falë një bashkëpunimi të ngushtë në mes të AMMK-së, GIZ-së dhe Asociacionit të Komunave të Kosovës (AKK). Ky bashkëpunim ka qenë i ndërlidhur ngushtë me Grantin e Performancës Komunale – “Mjedisi i Pastër” (2018-2020), ku komunat janë mbështetur me shuma të ndryshme financiare, varësisht prej nivelit të përmbushjes së indikatorëve të fushës së mbeturinave.

Nga donatorët si BE, GIZ, JICA, ka sinjale pozitive të vazhdimit të mbështetjes përmes investimeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave. Investimet do të jenë të natyrës direkte, por edhe përmes ngritjes së kapaciteteve profesionale përmes trajnimeve, zhvillimit të hulumtimeve dhe aspekteve tjera të mbështetjes teknike.

Sidoqoftë, investimet në projekte të mëdha kërkojnë analizë gjithëpërfshirëse dhe ato duhet të jenë të bazuara në dokumentet si Strategjia dhe Plani i Veprimit për Menaxhimin e Integruar të Mbeturave në Kosovë.

Në fund, raporti i përshkruan gjetjet që politikbërësit qoftë në nivelin lokal apo qendror, mund t'i përdorë me qëllim të planifikimit në të ardhmen.

Në përmbajtjen e këtij raporti janë paraqitur të dhënat për vitin raportues 2020, duke përdorur metodën e krahasimeve me të dhënat e viteve paraprake.

1.2. Fushëveprimi i raportit

Raporti mbulon përmbushjen e legjislacionit dhe dokumenteve planifikuese, të dhëna mbi gjendjen e mbeturave të ngurta të parrezikshme që prodhohen në Republikën e Kosovës duke përfshirë: mbeturinat komunale (MK) nga amvisëritë; mbeturinat komerciale (MKo) - që janë mbeturinat nga bizneset dhe institucionet arsimore dhe qeveritare; mbeturinat e demolimit dhe ndërtimit (N&D), që do të thotë mbeturinat nga aktivitetet e ndërtimit dhe demolimit të objekteve banesore, ekonomive familjare dhe afariste; mbeturinat e vëllimshme (MV), që do të thotë mbeturinat nga amvisëritë dhe bizneset.

Përmbajtja e këtij raporti paraqet një pasqyrë aktuale mbi gjendjen e menaxhimit të mbeturave komunale, përfshirë: zbatimin e legjislacionit, mbulimin me shërbim të mbledhjes dhe transportit të mbeturave, faturimin dhe arkëtimin, regjistrimin e deponive ilegale, sasinë e mbeturave komunale të grumbulluar dhe të gjeneruara sipas komunave, sasinë e mbeturave të deponuara, të dhëna lidhur me nismat e komunave për ndarjen e mbeturave në burim, efikasitetin e kostos së menaxhimit të mbeturave komunale etj.

1.3. Metodologjia e mbledhjes së të dhënave

AMMK ka bërë përgatitjet e nevojshme para fazës së raportimit (31 mars 2021), ashtu që me mbështetjen e GIZ-së, në bashkëpunim me Asociacioni i Komunave të Kosovës (AKK), si dhe me kompanitë e licencuara për mbledhjen dhe transportin e mbeturave komunale, janë zhvilluar takime ku është diskutuar për formatin, procedurën, si dhe afatet e raportimit për menaxhimin e mbeturave komunale për vitin 2020.

Të dhënat e prezantuara në këtë raport janë marrë nga raportimi i 36 komunave, kompanive të licencuara që merren me mbledhje dhe transport të mbeturave komunale (KRM) kompanitë e menaxhimit të deponive (KMDK) si dhe nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK). AMMK, ka bërë vlerësimin dhe verifikimin e këtyre të dhënave nëpërmjet një procesi të administruar mirë, në bashkëpunim me komunat dhe KRM-të.

Ky është viti i tretë me radhë që akterët e lartcekur raportojnë përmes formatit të unifikuar dhe të standardizuar të raportimit, që AMMK ka hartuar për këtë qëllim.

Ky raport është hartuar duke përdorur të dhënat e raportuara nga:

- Komunat, përmes zyrtarëve komunal, përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave;
- Operatorët e mbledhjes dhe transportit të mbeturinave (KRM, njësitë Komunale, etj.);
- Kompanitë e menaxhimit të deponive (KMDK, KRM etj.).
- Të dhëna nga ASK.

Për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga ana e komunave dhe kompanive, si për: numrin e amvisërive të shërbyera, shkallën e arkëtimit, sasinë e mbeturinave të gjeneruar dhe të deponuar, qasjen në infrastrukturën për ndarje e mbeturinave në burim, shkallën e përmbushjes së legjislacionit të fushës etj., është kërkuar dokumentacioni i nevojshëm nga komunat dhe operatorët. Dokumente të vlefshme janë: pasqyrat financiare, lista faturimi, raporte mbi sasinë e deponuara të mbeturinave, foto dhe koordinata nga lokacionet e deponive ilegale, kontrata etj.

Rezultatet e të dhënave për deponitë ilegale janë të bazuara nga regjistrimi në terren i realizuar në të gjitha komunat në mbarë vendin, në periudhën prill 2021. Pastaj, këto të dhëna janë raportuar në formularët e standardizuar të AMMK-së. Verifikimi i të dhënave të raportuara për deponitë ilegale është bërë përmes vizitave në lokacione të përzgjedhura në terren.

I gjithë procesi i verifikimit të saktësisë së të dhënave të raportuara dhe i dokumenteve të lartpërmendura është realizuar nga grupi teknik brenda MMPHI-së, janë dhënë vlerësimet dhe janë nxjerrë rezultatet e raportit për menaxhimin e mbeturinave komunale për vitin 2020.

AMMK e ka përcjellë raportin preliminar tek komunat për ta shqyrtuar, dhe pasi kemi pranuar disa reagime nga komunat, grupi teknik i ka trajtuar dhe adresuar brenda afatit optimal.

2.0. Korniza ligjore për menaxhimin e mbeturinave komunale në Kosovë

Ligji bazik i cili e rregullon fushën e mbeturinave komunale në Kosovë është Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, bazuar në të cilin edhe janë aprovuar edhe 45 Rregullore dhe Udhëzime Administrative të cilat rregullojnë fusha të caktuara specifike të mbeturinave. Ato që ndërlidhen direkt me mbeturinat komunale janë: Udhëzimi administrativ (QRK) Nr.08/2017 për menaxhimin e deponive të mbeturinave, Udhëzimi administrativ (QRK) Nr. 06/2016 mbi kushtet për zgjedhjen e lokacionit dhe ndërtimin e deponisë së mbeturinave, Udhëzimi Administrativ Nr.15/2012 për menaxhimin e deponive të mbeturinave, Udhëzimi Administrativ MMPH-Nr.06/2018 për ndëshkimet me gjoba mandatore, Udhëzimi administrativ MMPH–Nr.29/2014 për menaxhimin e lymit nga trajtimi i ujërave të ndotura, etj.

Ky ligj ka për qëllim evitimin dhe reduktimin sa më të madh të gjenerimit të mbeturinave, ripërdorimi i komponentëve të përdorshëm nga mbeturinat, zhvillimi i qëndrueshëm përmes mbrojtjes dhe ruajtjes së resurseve natyrore, parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut, si dhe deponimi përfundimtar i mbeturinave në mënyrë të pranueshme mjedisore.

Në klasifikimin dhe kategorizimin e llojeve të mbeturinave, mbeturinat komunale janë lloji i parë i përcaktuar dhe trajtuar ligjërisht.

Planifikimi dhe menaxhimi i mbeturinave bëhet përmes:

- Strategjisë së Republikës së Kosovës për Menaxhimin e Mbeturinave;
- Planit të Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave;
- Planit komunal për menaxhimin e mbeturinave;
- Planeve për menaxhimin e mbeturinave nga zotëruesit e mbeturinave; dhe
- Planet për menaxhimin e mbeturinave nga personat e licencuar.

Me miratimin e Strategjisë së Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (2021-2030) dhe Planit të Republikës së Kosovës për menaxhimin e mbeturinave (2021-2023), është planifikuar një qasje më e përshpejtuar e realizimit të objektivave strategjik, që do të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në aspektin e përmirësimit ekonomik dhe standardit jetësorë. Këta objektiva janë menduar në kuptimin e zhvillimit dhe përmirësimit të gjendjes në kët fushë.

Konform nenit 10 të Ligjit për Mbeturina. PRKMM dhe PKMM për menaxhimin e mbeturinave nxirren nga Ministria, gjegjësisht komuna me afat 5 vjeçar dhe mundësi revidimi sipas nevojës, si dhe përmbajtja që kërkohet decidivisht është përcaktuar në paragrafët 6 dhe 7 të nenit 10.

3.0. MENAXHIMI I MBETURINAVE KOMUNALE NË KOSOVË

3.1 Gjendja aktuale

Bazuar në monitorimet periodike që AMMK bënë në terren, me qëllim të vlerësimit të gjendjes së mjedisit, por edhe gjatë mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave nga raportet e menaxhimit të mbeturinave si: nga komunat, operatorët e licencuar për menaxhimin me mbeturina, KMDK, dhe të dhënave tjera, mund të themi se gjendja aktuale me menaxhimin e mbeturinave komunale ende kërkon një aktivizim më të madh dhe një qasje të mirë planifikuar.

Megjithat, shohim se vit pas viti po shënohet progres, dhe kemi dallime deri diku të theksuara si në mes të komunave ashtu edhe në mes të rajoneve, sa i përket përmirësimit të gjendjes mjedisore të atakuar nga menaxhimi jo i duhur i mbeturinave.

Në përgjithësi, në tërë vendin është shënuar një përmirësim i madh sa i përket eliminimit të deponive të egra, ku komunat janë angazhuar që ti pastrojnë lokacionet e caktuara me mbeturina. Janë rrit edhe inspektimet përmes inspektorateve komunale për mjedis dhe gjithashtu edhe vendosja e sinjalizimeve për ndalimin e hedhjes së mbeturinave në disa raste.

Nga të dhënat që kemi siguruar nga raportimi i komunave dhe operatorëve të licencuar, kemi bërë një analizë të mirëfilltë të tyre duke përfshirë gjithë ciklin e mbeturinave, duke filluar nga prodhimi e deri

tek trajtimi përfundimtar i tyre, dhe në bazë të numrave shohim një përmirësim të treguesve. Problemi ndoshta më i theksuar ende mbetet deponimi në deponitë sanitare i pjesës dërmuese të mbeturinave të cilat gjenerohen.

Mungojnë iniciativat e mirëfillta qoftë në nivel lokal apo edhe në nivel vendi, drejtë një ekonomie qarkore. Vetëm 7 komuna kanë qasje në njëfarë niveli të infrastrukturës për ndarjen e mbeturinave në burim.

Gjendja mjedisore në deponitë sanitare vit pas viti vetëm se është duke u keqësuar, në radhë të parë nga menaxhimi joadekuat, mungesa e investimeve rehabilituese, tejkalimi i kapaciteteve pranuese në deponi, mos paisja me leje te integruar etj.

Gjatë vitit 2020 edhe pse ka qenë një vit i rënduar me gjendjen e pandemisë Covid-19, megjithatë janë shënuar disa rezultate pozitive për disa indikatorë. Konkretisht, mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave ka shënuar një rritje rreth 7% krahasuar me vitin paraprak duke arritur kështu në nivelin prej 85 %. Niveli i arritjes së pajtueshmërisë ligjore ka shënuar një përmirësim prej 8%. Në anën tjetër kemi një rënie të nivelit të arkëtimit prej 3% krahasuar me vitin paraprak dhe një ngritje të gjenerimit prej 3%, apo 2.5 kg më shumë për kokë banori.

Sa i përket kapaciteteve të infrastrukturës së komunave për të trajtuar mbeturinat e veçanta siç janë ato shtazore, mjekësore, mbeturinat e ndërtimit dhe ato të vëllimshme, bazuar në raportet e mbledhura dhe pas analizimit të PKMM-ve kemi vlerësuar se nuk e bëjnë trajtimin e tyre. Gjithsesi se menaxhimi i mbeturinave komunale mbetet një sfidë për komunat, andaj duhet kërkuar rrugë që të rritet bashkëpunimi dhe koordinimi i aktiviteteve me nivelin qendrorë dhe anasjelltas, por edhe rritja e bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm, në mënyrë që të shtohen investimet dhe të realizohen projekte të qëndrueshme në menaxhimin e mbeturinave.

3.2 Gjenerimi i mbeturinave komunale

Nga analizimi dhe përpunimi i të dhënave të raporteve të pranuar nga komunat dhe KRM-të, është siguruar një bazë solide e të dhënave për të nxjerrë një rezultat të besueshëm të nivelit të gjenerimit të mbeturinave komunale gjatë vitit 2020.

Duhet të cekim se këto dhëna edhe në këtë vit raportues nuk mjaftojnë për të siguruar një pasqyrë të kompozicionit të mbeturinave qoftë nëpër komuna individuale apo edhe në nivel të rajoneve, e po ashtu as të dhëna të diferencuara për sasinë e mbeturinave të gjeneruara nga zonat rurale apo urbane.

Megjithatë, bazuar në të dhënat e siguruar nga raportet e komunave dhe operatorëve të licencuar, prej sasisë totale të mbeturinave të gjeneruara mund të llogaritet një gjenerim mesatar i mbeturinave për banorë në nivel të komunave, rajoneve dhe në nivel vendi.

Kështu, bazuar në raportin për sasinë e grumbulluar të mbeturinave, dhe duke pasur parasysh numrin e banorëve të shërbyer, mund të llogaritet norma e gjenerimit të mbeturinave për kokë banori në ditë, që në nivel vendi rezulton 0.74 kg/banor/ditë.

Andaj, duke marrë parasysh numrin prej 1.779.521 banorëve në vend (regjistrimi i popullsisë i vitit 2011 dhe vlerësimin e popullsisë për Mitrovicën Veriore, Leposaviq, Zubin Potok, Zveçan) dhe sasinë vjetore të mbeturinave komunale për kokë banori, që është afërsisht 0.74 kg/banor/ditë, sasia e përgjithshme e mbeturinave të gjeneruara rezulton të jetë rreth 480,648.62 ton/vit.

Nëse e krahasojmë sasinë e mbeturinave të gjeneruar prej 480,648.62 ton në vitin 2020, dhe sasinë e mbeturinave të deponuara prej 446,332.36 ton, shohim se kemi një shmangie prej 34,316 ton mbeturina që nuk kanë përfunduar në deponi. Supozohet se një pjesë e kësaj sasive të mbeturinave është marrë nga mbledhësit e sektori informal, kurse një pjesë ka përfunduar nëpër deponi të egra.

Të dhënat e detajuara lidhur me sasinë e mbeturinave të grumbulluara dhe të gjeneruara janë dhënë në shtojcën 1 të raportit.

Tabela 1. Sasia e MK të gjeneruara dhe të grumbulluara 2020

RAJONI	Të dhëna të përgjithshme dhe të shërbimit				Sasia e mbeturinave të grumbulluara (2020)	Gjenerimi i mbeturinave (2020) ¹	
	Numri i banorëve (ASK-2011)	Numri i banorëve të shërbyer	Numri i ekonomive familjare (ASK-2011)	Numri i ekonomive familjare të shërbyera (12/2020)	Mbeturinat e përziera komunale të grumbulluara (ton/vit)	Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/ vit)	Gjenerimi i mbeturinave për kokë banori (kg/ ditë)
RAJONI I PRISHTINËS	470,583.00	534,205.18	85,104.00	96,336.00	140,564.02	263.13	0.72
RAJONI I MITROVICËS	206,734.00	181,661.64	36,312.00	33,146.00	54,160.05	277.77	0.76
RAJONI I PEJËS	174,235.00	150,137.88	30,266.00	26,511.00	53,227.50	354.52	0.97
RAJONI I PRIZRENIT	387,828.00	372,390.46	60,651.00	58,756.00	84,894.45	227.97	0.62
RAJONI I GJILANIT	188,188.00	120,013.43	34,387.00	24,938.00	35,902.37	299.15	0.82
RAJONI I GJAKOVËS	140,659.00	110,970.14	22,960.00	19,328.00	29,080.00	262.05	0.72
KOSOVË	1,753,922.00	1,583,308.61	300,681.00	279,801.00	430,145.07	271.67	0.74

¹ Gjenerimi bazohet në sasinë e mbeturinave komunale të grumbulluara. Në llogaritje nuk janë përfshirë mbeturinat që nuk grumbullohen dhe ato të vëllimshme.





Figura 1. Gjenerimi i MK sipas rajoneve dhe në nivel vendi shprehur në kg/banor/vit, (2019 & 2020)



Harta 1. Gjenerimi i MK në komuna shprehur në kg/banor/vit (2019&2020)

3.3 Deponimi i mbeturinave komunale

Sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare, siç mund ta shohim në tabelën në vijim ka shkuar duke u rritur nga viti në vit. Ajo që vërejmë është se në vitin 2020, krahasuar me trendin e viteve paraprake, rritja e sasisë së mbeturinave të deponuara ka qenë shumë e vogël në deponitë sanitare, madje në dy prej tyre më pak se në vitin 2019.

Në deponitë që menaxhohen nga KMDK-ja, sasia e mbeturinave të deponuara për vitin 2020 është **340,790.98 ton/vit**, duke shënuar një rritje prej vetëm **1%** krahasuar me vitin 2019.

Ndërkaq, në deponitë e tjera sanitare që menaxhohen nga KRM-të, sasia e mbeturinave të deponuara është rreth **105,541.38 ton/vit**, apo për rreth **6% më pak se në vitin 2019**.

Në total, sasia e mbeturinave komunale e deponuar në deponitë sanitare shkon në **446,332.36 ton/vit**, me një rënie prej **3,549 ton** apo rreth **1% më pak** mbeturina të deponuara se në vitin 2019.

Këtu nuk është përfshirë sasia e mbeturinave të deponuara në deponitë tjera jo sanitare, si ajo në Istog (Tuçep), apo në deponitë tjera në pjesën veriore të Kosovës, pasi nuk ka të dhëna të raportuara.

Tabela 2. Sasia e MK të deponuara/shprehur në ton

Deponitë Sanitare	2015	2016	2017	2018	2019	2020
Prishtinë (Mirash)	104,742.68	116,529.00	116,355.77	126,351.47	150,921.83	152,215.43
Gjilan (Velekincë)	52,045.83	58,215.98	62,036.98	65,366.98	66,740.60	67,075.81
Podujevë (Dumnicë)	10,315.42	10,552.70	11,083.00	12,603.60	15,676.18	16,194.56
Prizren (Landovicë)	79,661.07	89,897.79	90,858.81	95,637.99	104,058.58	105,305.18
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KMDK-ja:	246,765.00	275,195.47	280,334.56	299,960.04	337,397.19	340,790.98
Mitrovicë (Gërmovë)	39,546.52	43,863.36	64,663.05	62,109.22	53,729.62	47,415.38
Pejë (Sferk)	44,424.00	48,342.00	47,926.00	49,451.00	52,688.00	52,496.00
Dragash (Sharr)	4,577.00	5,201.50	5,530.50	5,797.00	6,067.00	5,630.00
Nëntotali në deponitë e menaxhuara nga KRM-të:	88,547.52	97,406.86	118,119.55	117,357.22	112,484.62	105,541.38
Deponia në Istog (Tuçep) *						
Deponia në Zveçan*						
Zubin-Potokut (Lluçkarekë)*						
Deponia në Lepasaviq*						
Totali	335,312.52	372,602.33	398,454.11	417,317.26	449,881.81	446,332.36

*Gjatë këtij viti raportues nuk janë raportuar të dhëna për këto deponi.




Figura.2. Trendi i deponimit të mbeturinave komunale

3.4. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale

Shërbimi themelorë që komunat dhe operatorët e licencuar ofrojnë për qytetarët sa i përket mbeturinave komunale, është mbledhja, transporti dhe deponimi përfundimtar në deponi sanitare. Në hartën në vijim është ofruar një pasqyrë e shkallës së mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave sipas komunave, në vitin 2020. Në tabelën 3 në vijim është dhënë mbulimi me shërbim sipas rajoneve, kurse në figurën 3, është dhënë mbulimi me shërbim sipas komunave shprehur në %.

Në shtojcën 2 është paraqitur shkalla e mbulimit me shërbim të mbeturinave për të gjitha komunat në Kosovë, në formë të detajuar.

Mbulimi me shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonomitë familjare deri në fund të vitit 2020 në nivel vendi qëndron në 85.3%, (duke shënuar një rritje prej rreth 7% më shumë krahasuar me vitin 2019, kurse për biznese në 53.7%, respektivisht në 84.8% për institucione.

Rajoni i Prizrenit ka shkallën më të lartë të mbulimit me shërbim për ekonomitë familjare me 94.2% i pasuar nga rajoni i Mitrovicës me 90.4%, kurse shkalla më e ulët e mbulimit me shërbim është shënuar në rajonin e Ferizajt me 70.00%.

Sipas të dhënave të raportuara nga 36 komuna sa kanë raportuar në AMMK, 8 komuna tashmë kanë arritur shkallën e mbulimit me shërbim në 100%.

Duhet cekur një fakt me rëndësi se për shkak të dhënave zyrtare tashmë të vjetruara nga ASK (regjistrimi i popullsisë 2011) sa i përket numrit të banorëve dhe ekonomive familjare në komuna, si dhe ndryshimit të madh në trendet e rritjes së popullsisë gjatë këtyre viteve, një numër i konsiderueshëm i komunave kanë numër më të madh të ekonomive familjare të cilat faturohen, në raport me numrin e përgjithshëm të ekonomive familjare të cilat merren si referencë nga ASK, si p.sh: Komuna e Prishtinës, Prizrenit, Fushë Kosovës, Vushtrrisë, por edhe komunave tjera.

Po ashtu, një numër i komunave kanë marrë përsipër arkëtimin nga operatorët dhe kanë shfrytëzuar të dhënat e tatimit në pronë për procesin e arkëtimit, apo kanë gjetur ndonjë mënyrë tjetër për të siguruar regjistrimin e ekonomive familjare në regjistrin e arkëtimit. Kështu, numri i ekonomive familjare është shumë më i madh se sa ai në regjistrimin e popullsisë dhe ekonomive familjare në vitin 2011, duke e vështirësuar kështu paraqitjen reale të të dhënave me gjendjen në terren.

Në anën tjetër, në disa komuna tjera, siç janë: Rahoveci, Kaçaniku, Podujeva, Suhareka, etj., operojnë kompanitë private të licencuara për mbledhjen e mbeturinave, por të cilat nuk janë kontraktuar përmes procedurave të prokurimit publik. Andaj, të dhënat (faturimi) që janë raportuar nga këto kompani nuk janë llogaritur.

Komunat kanë raportuar mbulimin me shërbim edhe për kategorinë e bizneseve dhe institucioneve, por duhet cekur se shumë komuna ende nuk kanë arritur të bëjnë një filtrim të bizneseve aktive dhe atyre pasive. Kështu, duke ofruar një numër të përgjithshëm të bizneseve, mbulimi me shërbim supozohet të rezultojë më i ulët sesa është paraqitur në raport.

Për llogaritjen e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave është përdorur përkufizimi i mëposhtëm:

$$SHm = \frac{N_{ef. sh}}{N_{p. ef.}} \times 100\%$$

* SHm Shkalla e mbulimit

* N ef.sh. – Numri i ekonomive familjare të shërbyera/ të faturuara në dhjetor 2019/2020

* N p.ef. – Numri i përgjithshëm i ekonomive familjare, sipas regjistrimit të popullsisë ASK-2011

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave komunale janë dhënë në shtojcën 2 në raport.

Tabela 3. Mbulimi me shërbim të mbledhjes së MK, (2019&2020)

RAJONI	Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes së mbeturinave				
	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2019)	Shkalla e mbulimit me shërbim për ekonomi familjare (2020)	Rritja ose zbritja e shkallës së mbulimit për ekonomi familjare 2019 -2020 (pikë %)	Shkalla e mbulimit me shërbim për biznese (2020)	Shkalla e mbulimit me shërbim për institucione (2020)
RAJONI I PRISHTINËS	85.2%	89.2%	4.0%	56.7%	48.0%
RAJONI I MITROVICËS	83.2%	90.4%	7.2%	95.9%	97.5%
RAJONI I PEJËS	85.1%	87.6%	2.5%	71.2%	93.7%
RAJONI I PRIZRENIT	95.2%	94.2%	-1.0%	70.5%	90.0%
RAJONI I FERIZAJT	63.2%	70.4%	7.2%	16.5%	73.4%
RAJONI I GJILANIT	55.4%	72.0%	16.6%	29.8%	94.9%
RAJONI I GJAKOVËS	72.5%	80.4%	7.9%	90.2%	92.7%
KOSOVË²	78.5%	85.3%	6.8%	53.7%	84.8%

² Shkalla e mbulimit me shërbim, në disa komuna është rumbullaksuar në 100%, kjo ka ndodhë për shkak se numri i ekonomive familjare që ju kemi referuar për llogaritje të këtij indikator është bazuar nga të dhënat e ASK-së, që ndryshon nga numri real i ekonomive familjare në disa komuna, në nivel të rajoneve dhe në nivel të vendit.




Figura 3. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK nga ekonomitë familjare sipas komunave, (2019&2020)





Figura 4. Mbulimi me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas rajoneve dhe në nivel vendi, (2019&2020)



Harta 2. Shkalla e mbulimit me shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK sipas komunave, (2019&2020)

3.5. Faturimi dhe Arkëtimi

Nuk ka asnjë dilemë se qëndrueshmëria financiare është një nga shtytësit kryesorë në sistemin e menaxhimit të mbeturinave. Komunat e Kosovës, përkatësisht KRM-të, vazhdimisht ballafaqohen me vështirësi dhe qëndrueshmëri financiare, andaj gjenerimi i të ardhurave dhe një planifikim më i mirë i orientimit të kostove operative çojnë në përmirësimin e performancës së shërbimit si tërësi.

Megjithatë shkalla aktuale e arkëtitimit në Kosovë ka shënuar një rritje nga vitit në vit, duke e përmirësuar gjendjen financiare të KRM-ve, dhe është një tregues i qartë i vullnetit të klientëve për t'i paguar tarifatat për shërbimet e mbledhjes së mbeturinave dhe/ose aftësisë së komunave për ta modernizuar dhe përmbaruar pagesën e tarifave. Shkalla e arkëtitimit po ashtu ofron një mundësi që komunat të reflektojnë për cilësinë e shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave dhe, kështu, ti shtojnë përpjekjet për rritjen e arkëtitimit.

Në vitin 2020 shkalla e arkëtitimit për ekonomi familjare, në nivel vendi ka arritur në 90.84%, duke shënuar një rritje vetëm 0.5% krahasuar me vitin 2019 që ishte 90.4%, kurse shkalla e arkëtitimit për biznese ka arritur në 79.30%, rrespektivisht në 93.51% për institucione.

Problematike mbetet ende fakti se operatorët nuk kanë mundur të bëjnë dallimin në mes të arkëtitimit nga faturimi për vitin përkatës dhe viteve të kaluara (borxhet e vjetra). Andaj, supozohet se shkalla aktuale e arkëtitimit është më e ulët se ajo që paraqitet nga formula dhe shkalla e arkëtitimit nuk reflekton domosdoshmërisht shkallën reale në arkëtimin e faturave të vitit raportues.

Në vitin raportues 2020, 5 komuna shkallën e arkëtitimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave për ekonominë familjare e kanë arritur në 100%.

Në nivel të rajoneve shkallën më të lartë të arkëtitimit për ekonominë familjare e ka arritur rajoni i Mitrovicës me 97.10%, i pasuar nga rajoni i Prizrenit me 92%, kurse shkalla më e ulët e arkëtitimit është regjistruar në rajonin e Gjakovës me 89.3%.

Të dhënat për shkallën e arkëtitimit janë llogaritur duke e përdorur formulën në vijim:

$$SHa = \frac{sh.f.l.v}{sh.f.a} \times 100\%$$

*SHa - Shkalla e arkëtitimit

*shf.l.v - Shuma e faturave të lëshuara në vit

*shf.a – Shuma e faturave të arkëtuara në vitin përkatës

Viteve të fundit, disa komuna si ajo e Prishtinës, Prizrenit, Mitrovicës etj, kanë ndërmarrë reforma dhe veprime për ta ngritur shkallën e arkëtitimit, ashtu që e kanë marrë përsipër arkëtimin nga KRM-të. Në këto raste tarifatat janë shndërruar në taksë komunale, duke e mundësuar kështu një arkëtim më të lehtë, pra përmes kushtëzimit të shërbimit.

Listat e të dhënave për klientë që shërbehen duhet të përditësohen dhe të harmonizohen p.sh. me regjistrin e pronave, kadastrën, korporatën energjetike ose ujësjellësin dhe të azhurnohen rregullisht.

Të dhënat e detajuara lidhur me shkallën e arkëtitimit janë dhënë në shtojcën 3 në raport.

Tabela 4. Faturimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020)

RAJONI	Faturimi për shërbim të ekonomive familjare (2020)	Faturimi për shërbim të bizneseve (2020)	Faturimi për shërbim të institucioneve (2020)
RAJONI I PRISHTINËS	€ 4,665,736.57	€ 806,229.61	€ 233,254.99
RAJONI I MITROVICËS	€ 1,221,063.70	€ 577,296.86	€ 1,345,104.55
RAJONII PEJËS	€ 1,433,728.84	€ 412,931.19	€ 200,275.49
RAJONI I PRIZRENIT	€ 2,312,705.94	€ 298,378.66	€ 114,357.25
RAJONI I FERIZAJT	€ 1,107,634.40	€ 302,069.80	€ 198,600.17
RAJONI I GJILANIT	€ 1,157,691.34	€ 281,679.56	€ 117,545.69
RAJONI I GJAKOVËS	€ 1,023,536.67	€ 280,115.13	€ 106,929.67
KOSOVA	€12,922,097.45	€2,958,700.81	€2,316,067.81

Tabela 5. Shkalla (%) e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2020)

Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes së mbeturinave në vitin 2020 (%)			
RAJONI	Shkalla e arkëtimit për shërbim të ekonomive familjare (2020)	Shkalla e arkëtimit për shërbim të bizneseve (2020)	Shkalla e arkëtimit për shërbim të institucioneve (2020)
RAJONI I PRISHTINËS	89.62%	74.41%	119.12%
RAJONI I MITROVICËS	97.10%	88.51%	94.09%
RAJONI I PEJËS	90.47%	94.15%	93.45%
RAJONI I PRIZRENIT	92.05%	92.81%	101.57%
RAJON I IFERIZAJT	89.50%	34.01%	39.05%
RAJONI I GJILANIT	89.88%	78.41%	107.60%
RAJONI I GJAKOVËS	89.32%	87.78%	107.50%
KOSOVË³	90.84%	79.30%	93.51%

³ Shkalla e arkëtimit në nivel vendi, bazuar në formulën e llogaritjes, ndryshon nga totali i përqindjeve në nivel të rajoneve.




Figura 5. Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare në rajone dhe në nivel vendi (2019&2020)





Figura 6. Arkëtimi për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK për ekonomitë familjare sipas komunave, (2019&2020)



Harta 3. Shkalla e arkëtimit për shërbim të mbledhjes dhe transportit të MK, (2019&2020)

3.6. Deponitë ilegale

Gjatë muajit prill të vitit 2021 është bërë evidentimi dhe regjistrimi i deponive ilegale në të gjitha komunat në Kosovë.

Deponitë e regjistruara për nga madhësia e tyre janë klasifikuar në tri kategori si: deponi të mëdha, të mesme dhe të vogla. Ky klasifikim është bërë duke vlerësuar vizualisht vëllimin e deponive.

Kategorizimi tjetër i deponive ilegale është bërë edhe sipas kompozicionit të mbeturinave, si: (a) deponi të mbeturinave komunale; (b) deponi të mbeturinave të ndërtimit dhe rrënit; (c) deponi të mbeturinave të rrezikshme; (d) deponi të mbeturinave të vëllimshme; dhe (e) deponi të mbeturinave të tjera.

Gjatë këtij procesi, në nivel të Kosovës, në 38 komuna janë regjistruar gjithsej 1189 deponi ilegale të madhësive të ndryshme, ndërsa dominojnë kategoria e deponive të mëdha me 558 të tilla. Në rajonin e Prishtinës është regjistruar numri më i madh i deponive ilegale, gjithsej 277, kurse në Rajonin e Gjakovës është regjistruar numri më i vogël i deponive, gjithsej 32 deponi.

Numri më i madh i deponive ilegale është regjistruar në komunën e Lipjanit, gjithsej 126 deponi, kurse në Komunën e Junikut nuk është regjistruar asnjë deponi ilegale në vitin 2020.

Krahasuar me vitin 2019 kemi një progres të theksuar në pastrimin e deponive ilegale, dhe kemi një rënie prej 300 më pakë deponi.

Deponitë ilegale kryesisht dominohen nga mbeturinat e përziera (61%), pasuar nga ato të ndërtim-demolimit dhe ato komunale.

Të dhënat e detajuara për deponitë ilegale janë dhënë në shtojcën 4 në raport.

Tabela 6.. Deponitë ilegale sipas fraksioneve të mbeturinave, (Prill 2021)

RAJONI	Deponitë ilegale sipas fraksioneve				
	Mbaturina komunale	Mbaturinat të ndërtimit dhe demolimit	Mbaturinat indust. dhe të rrezikshme	Mbaturinat të vëllimshme	Mbaturinat tjera
RAJONI I PRISHTINËS	25.3%	30.7%	0.0%	0.6%	43.3%
RAJONI I MITROVICËS	19.6%	21.2%	0.0%	0.0%	59.2%
RAJONII PEJËS	27.3%	8.7%	8.0%	0.3%	55.7%
RAJONI I PRIZRENIT	12.2%	20.2%	0.0%	0.3%	67.3%
RAJONI I FERIZAJT	11.8%	14.2%	0.0%	0.0%	74.0%
RAJONI I GJILANIT	23.0%	17.9%	0.0%	0.0%	59.1%
RAJONI I GJAKOVËS	0.0%	9.5%	0.0%	0.0%	90.5%
KOSOVË⁴	18.6%	19.5%	0.7%	0.2%	61.0%

⁴ Shkalla e % së deponive ilegale sipas fraksioneve në nivel vendi, është llogaritur duke e eliminuar komunën e Junikut, pasi nuk është regjistruar asnjë deponi në këtë komunë.




Figura.7. Deponitë ilegale sipas fraksioneve në nivel vendi (%)

Tabela 7. Deponitë ilegale sipas madhësisë në rajone, (Prill 2021)

RAJONI	Deponitë ilegale sipas madhësisë			Deponi ilegale gjithsej
	Nr. Deponi të vogla (1-5 thasë mbeturinash 200 litra)	Nr. Deponi të mesme (6-20 thasë mbeturinash 200 litra)	Nr. Deponi të mëdha (>20 thasë mbeturinash 200 litra)	
RAJONI I PRISHTINËS	61	75	141	277
RAJONI I MITROVICËS	19	39	42	101
RAJONII PEJËS	58	45	53	156
RAJONI I PRIZRENIT	59	68	129	256
RAJONI I FERIZAJT	22	31	65	118
RAJONI I GJILANIT	49	94	99	242
RAJONI I GJAKOVËS	3	7	29	39
KOSOVË	271	359	558	1189

Numri i deponive ilegale sipas madhësisë





Figura 8. Numri i deponive ilegale sipas madhësisë në nivel vendi



Harta 4. Deponitë ilegale sipas komunave, (Prill 2021)

3.7. Efikasiteti i kostos se menaxhimit të mbeturinave komunale

Efikasiteti i kostos, është futur si tregues për her të parë në këtë vit raportues.

Qëllimi i këtij treguesi është që të shohim se si komunat ofrojnë shërbime efikase brenda intervalit të kostove siç përcaktohet në llogaritjet e kostos të përdorura për vendosjen e një tarife shërbimi që mbulon koston.

Cilësia e shërbimit dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimit mund të kufizohen rëndë nëse shërbimet nuk ofrohen në një mënyrë ekonomike dhe me kosto efektive. Ofrimi i shërbimeve joefikase është një pengesë kryesore zhvillimore që duhet adresuar.

Kostot e grumbullimit të mbetjeve ndryshojnë ndjeshëm në varësi të nivelit dhe tipologjisë së shërbimeve. Prandaj, efikasiteti i kostos matet dhe vlerësohet në lidhje me vlerësimin e kostos për komunën e caktuar kur përcaktohet niveli i tarifës së shërbimit.

Komunat dhe ofruesit e mandatuar të shërbimeve raportojnë mbi eficientë e kostos bazuar në vlerësimet e tyre të brendshme të kostos dhe duhet ta mbështesin me dokumentacion tjetër zyrtar. Relevante janë kostot që ndahen zyrtarisht për shërbimet e menaxhimit të mbetjeve dhe merren parasysh gjatë llogaritjes së kostove të shërbimeve të menaxhimit të mbetjeve.

Edhe pse kërkesat e këtij treguesi kanë qenë që efikasiteti i kostos të llogaritet për sasinë e mbeturinave të mbledhura në ton, megjithatë gjatë raportimit komunat-ofruesit e mandatuar të shërbimeve, nuk kanë arritur që raportimin ta mbështesin me dokumentacion adekuat dhe të qartë. Andaj në këto rrethana, pas shqyrtimit të raporteve, për llogaritjen e efikasitetit të kostos është marrë për bazë numri i stafit të ofruesit të shërbimeve për 1000 klient të shërbyer.

Tabela 8. Efikasiteti i kostos së menaxhimit të mbeturinave, 2020

Efikasiteti i kostos se MM				
Nr .	Emri i komunës	Stafi i Ofruesit të Shërbimeve	Konsumatorët e shërbyer	Efikasiteti i stafit për 1000 konsumatorë të shërbyer
1	Prishtine	678	63,832	10.6
2	Drenas	44	7,988	5.5
3	Fushe Kosove	56	12,818	4.4
4	Gracanice	145	-	-
5	Lipjan	45	8,369	
6	Obiliq	34	3,360	10.1
7	Podujeve	51	9,204	5.5
8	Mitrovice	156	14,105	11.1
9	Skenderaj	45	5,400	8.3
10	Vushtrri	73	14,758	4.9
11	Mitrovica e Veriut		-	-
12	Zvecan	51	1,813	28.1
13	Zubin Potok	45	-	-
14	Leposaviq		-	-
15	Pejë/Peć	126	19,253	6.5
16	Istog/Istok	35	5,624	6.2

17	Klinë/Klina	32	5,682	5.6
18	Prizren		35,589	-
19	Suharekë	51	5,902	8.6
19	Malishevë	58	7,861	7.4
21	Rahovec	61	10,765	5.7
22	Dragash	33	4,990	6.6
23	Mamushë	11	465	
24	Ferizaj	161	15,191	10.6
25	Kaçanik	32	3,723	
26	Shtime		3,222	-
27	Hani i Elezit	20	1,402	14.3
28	Shterpce		-	-
29	Gjilan	80	15,357	5.2
30	Kamenicë	15	4,555	3.3
31	Viti	16	4,133	3.9
32	Novobërdë	7	1,224	5.7
33	Parteš/Partesh	7	1,038	6.7
34	Klllokot		-	-
35	Ranillug		1,007	-
36	Gjakovë	145	14,828	9.8
37	Deçan	40	7,090	5.6
38	Junik	9	1,095	-
	Total:	2362	311643	8.0

3.8. Sistemet e ndara për mbeturina të veçanta

Edhe indikator: Sistemet e ndara për mbeturina të veçanta është raportuar për herë të parë në raportin për vitin 2020 nga ana e komunave. Qëllimi i këtij indikator është që komunat të nisin përpjekjet e tyre për të krijuar sisteme të veçanta të menaxhimit për rrjedhat e mbeturinave të ndërtimit dhe demolimit, mbeturinave të vëllimshme, nënprodukteve të kafshëve dhe mbetjeve të kujdesit shëndetësor.

Ky tregues mat aktivitetet e komunave për të integruar plane të tilla në planifikimet investive dhe në ofrimin e shërbimeve. Në PKMM, komunat i kanë futur me prioritet këto rryma mbetjesh, andaj edhe indikator synon matjen e zbatimit të këtyre planeve.

Megjithatë, bazuar në rezultatet e nxjerra nga raportet e komunave dhe shqyrtimit të PKMM-ve, kemi gjetur se në përgjithësi komunat nuk e kanë pasqyruar saktë se si do të jenë prioritare në menaxhim këto rryma mbetjesh, meqenëse nuk i kanë definuar mirë seksionet e veçanta të planifikimit të niveleve të shërbimit, modeleve operacionale, vlerësimit të kostos dhe financimit (përfshirë alokimin buxhetor) dhe investimet e nevojshme, ose edhe në rastet kur i kanë definuar mirë, nuk kanë ndërmarrë hapa në kryerjen e shërbimeve adekuate.

Kështu, rezultatet e këtij indikator në tabelën e mëposhtme janë fituar kur të gjitha aspektet e përmendura më sipër mbulohen për rrjedhën e caktuar të mbetjeve, d.m.th, PKMM-të janë shqyrtuar dhe nëse është gjetur se janë përfshirë këto rryma mbetjesh dhe janë pasqyruar qartë me seksionet: qëllimin, objektivat, masat/aktiviteti dhe buxheti është alokuar, atëherë është gjeneruar edhe tabela me rezultatet

për secilën komunë. Komunitat që kanë ofruar një përshkrim të qartë të këtyre rrymave të mbetjeve janë vlerësuar me vlerën 1, kurse disa komuna edhe pas shqyrtimit të PKMM-ve, është parë se nuk i kanë harmonizuar qartë ose ju mungojnë plotësisht, andaj vlerësimi është dhënë me vlerën 0.

Tabela.9. Ssitetmet e ndara për mbeturina të veçanta

SISTEME TË NDARA PËR MBETURINA TË VEÇANTA 2020						
Nr.	Komuna	Total Vlerësimi				Niveli i përputhshmërisë në PKMM
		Mbeturinat nga Ndërtim Demolimi	Mbeturinat e Vëllimshme	Mbeturinat shtazore dhe nga nën-produktet shtazore	Mbeturinat mjekësore	
1	Prishtinë	1	1	1	1	4
2	Drenas	1	0	1	1	3
3	Fushë Kosovë	0	0	1	1	2
4	Gracanice	1	1	0	0	2
5	Lipjan	0	0	1	1	2
6	Obiliq	0	0	1	1	2
7	Podujeve	0	0	1	1	2
8	Mitrovice	0	0	1	1	2
9	Skenderaj	0	0	1	1	2
10	Vushtrri	0	0	0	0	0
11	Mitrovica e Veriut	-	-	-	-	-
12	Zvecan	1	1	1	1	4
13	Zubin Potok	1	1	1	1	4
14	Leposaviq	-	-	-	-	0
15	Pejë	0	0	1	1	2
16	Istog	1	1	1	1	4
17	Klinë	1	1	1	1	4
18	Prizren	0	0	1	1	2
19	Suharekë	1	0	0	0	1
19	Malishevë	0	0	0	0	0
21	Rahovec	0	0	0	0	0
22	Dragash	0	0	0	0	0
23	Mamushë	0	0	1	1	2
24	Ferizaj	1	1	1	1	4
25	Kaçanik	0	0	0	0	0
26	Shtime	1	1	1	1	4
27	Hani i Elezit	0	0	0	0	0
28	Shterpce	0	0	0	0	0
29	Gjilan	0	0	1	1	2
30	Kamenicë	1	1	1	1	4
31	Viti	0	0	1	1	2
32	Novobërdë	1	1	1	1	4
33	Partesh	0	0	1	1	2
34	Kllokot	1	0	0	0	1
35	Ranilug	0	0	0	0	0
36	Gjakovë	0	0	1	1	2
37	Deçan	1	1	1	1	4
38	Junik	0	0	1	1	2

*Me numrin 1 janë vlerësuar komunitat që i kanë përfshirë qartë në PKMM trajtimimin e këtyre rrymave të mbetjeve, kurse me numrin 0 komunitat në rastin e kundërt.

3.9. Ndarja e mbeturinave në burim - Riciklimi

Edhe në këtë vit raportues, sikurse edhe në vitet paraprake, nga raportet e komunave dhe operatorëve të licencuar, nuk është marrë informacion i plotë për aktivitetet e ndarjes së mbeturinave në burim dhe pr riciklimin.

AMMK nga komunat ka kërkuar që të raportohet për numrin e ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarjen e mbeturinave në burim, duke përfshirë këtu të gjitha ekonomitë familjare që janë brenda rrezes 250 m nga një pikë grumbullimi të mbeturinave që ofron ndarje të mbeturinave të riciklueshme, ekonomitë familjare që janë pajisur me komposter dhe ekonomitë familjare në rreze 5 km nga një qendër për grumbullimin e mbeturinave të ndara.

Kështu, nga 36 komuna sa kanë raportuar për menaxhim të mbeturinave në vitin 2020, vetëm 7 komuna kanë rezultuar të kenë ofruar qasje në infrastrukturën për ndarje në burim. Këta hapa të parë në drejtim të ekonomisë qarkore i kanë ndërmarrë komunat: Drenas, Fushë Kosovë, Podujevë, Mitrovicë, Pejë , Rahovec dhe Ferizaj.

Për të gjitha këto komuna, të dhënat e raportuara janë vërtetuar me dokumente planifikimi dhe me foto dëshmi të lokacioneve, ortofoto, listë të vendbanimeve etj.

Në përgjithësi, në bazë të të dhënave të raportuara, rezulton se në nivel vendi në vitin 2020 numri i ekonomive familjare që kanë qasje në infrastrukturën për ndarje në burim është në nivelin 5%, apo 15,061 ekonomi familjare.

Sa i përket riciklimit, komunat nuk kanë qenë në gjendje që të ofrojnë të dhëna cilësore lidhur me aktivitetin e riciklimit, andaj, edhe gjatë përpunimit të të dhënave të raporteve kemi parë se nuk mundemi me ofru ndonjë shifër të përafërt të sasisë së mbeturinave që riciklohen nëpër komuna. Kjo do të mbetet si një pikë kyçe që në të ardhmen të fokusohemi më tepër në pasurimin me të dhëna të aktivitetit të riciklimit që ndodhë në Kosovë.

Të dhënat e detajuara lidhur me ndarjen e mbeturinave në burim janë dhënë në shtojcën 5 në raport.

3.10 Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave

Me Ligjin Nr. 04/L-060 për Mbeturina, nga i cili derivojnë aktet e tjera nënligjore dhe dokumentet planifikuese të nivelit qendror dhe lokal, formësohet korniza ligjore që mbulon fushën e menaxhimit të mbeturinave. Me këtë bazë ligjore përcaktohen edhe detyrat dhe përgjegjësitë e komunave për menaxhim të mbeturinave brenda territorit të tyre.

Përmbushja e kësaj kornize ligjore, është një parakusht për nivelin lokal, me qëllim ndërmarrjen e hapave konkret për realizimin e caqeve dhe objektivave të paracaktuara.

Disa nga obligimet që dalin nga baza ligjore, përmbushja e të cilave është kyçe për t'ua mundësuar komunave zbatimin e ligjit dhe planeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave, janë:

1. Hartimi dhe miratimi i RrKMM-së;
2. Hartimi dhe miratimi i PKMM);
3. Punësimi i përhershëm i zyrtarit për menaxhim të mbeturinave, përshkrimi i punës i të cilit siguron që të paktën 50% e përgjegjësive janë për menaxhim të mbeturinave;
4. Punësimi i inspektorit mjedisor, përshkrimi i punës i të cilit siguron përgjegjësi në fushën e menaxhimit të mbeturinave;
5. Kontraktimi i operatorëve të licencuar për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave komunale, duke zbatuar procedurat e prokurimit;
6. Kontraktimi i operatorëve të licencuar për mbledhjen dhe transportin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore, duke zbatuar procedurat e prokurimit;
7. Caktimi i tarifave të shërbimit duke kaluar procesin tarifor për mbledhjen, transportin dhe deponimin e mbeturinave komunale, përmes kalkulimit të kostove të shërbimit, profilizimin e klientëve dhe caktimin e tarifave të shërbimit;
8. Caktimi i qendrës për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore;
9. Përcaktimin e strukturës organizative të organizimit të inspektoratit në Komunë, si dhe;
10. Shqiptimin e gjobave mandatore.

Siç dihet, komunat kanë përgjegjësi të përmbushjes së obligimit ligjor për raportim brenda afatit të përcaktuar deri më 31 mars të vitit vijues për vitin raportues paraprak.

Bazuar në këto raporte, dhe më pas në verifikimin e këtyre të dhënave, është paraqitur një pasqyrë e përgjithshme e realizimit të proceseve në pajtueshmëri me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave.

Rajoni i Prishtinës ka shënuar nivelin më të lartë të përmbushjes së proceseve ligjore me 84%, kurse Rajoni i Gjilanit ka arritur nivelin më të ulët prej 53%.

Ndërkaq, niveli i realizimit të këtyre 10 proceseve-kërkesave ligjore në nivel vendi në vitin 2020, ka arritur në 69.4%., me një përmirësim prej 5.2% krahasuar me vitin 2019.

Tabela. 10. Pajtueshmëria me kornizën ligjore dhe planifikuese për menaxhim të mbeturinave, (2019&2020)

RAJONI	Viti	1.Hartimi dhe miratimi i PKMM	2.Hartimi dhe miratimi i rregullores komunale për menaxhim të mbeturinave	3.Zyrtari për MM	4.Inspektori mjedisor	5.Kontraktimi i operatorëve të licencuar për grumbullim dhe transport të mbeturinave komunale	6.Kontraktimi i operatorëve të licencuar për grumbullim dhe transport të mbeturinave të N dhe D	7.Caktimi i tarifave të shërbimit duke kaluar procesin tarifor	8.Caktimi i qendrës për grumbullim, trajtim dhe deponim të mbeturinave të N dhe D	9. Struktura organizative e cila pasqyron inspektoratin në komunë	10. Raportimi i komunës për gjambat mandatore të shqiptuara gjatë vitit raportues	Mesatarja e proceseve të zbatuara
PRISHTINËS	19	100%	100%	100%	71%	57%	0%	100%	71%	100%	71%	77.0%
	20	100%	100%	100%	71%	100%	0%	100%	71%	100%	100%	84.3%
MITROVICËS	19	80%	60%	80%	80%	60%	0%	100%	60%	80%	60%	66.0%
	20	100%	60%	80%	80%	60%	0%	100%	60%	80%	60%	68.0%
PEJËS	19	100%	100%	100%	100%	33%	0%	100%	33%	100%	67%	73.3%
	20	100%	100%	100%	100%	33%	0%	100%	33%	100%	100%	76.7%
PRIZRENIT	19	50%	50%	67%	100%	83%	0%	17%	67%	100%	50%	58.4%
	20	67%	83%	100%	100%	83%	0%	17%	83%	100%	100%	73.3%
FERIZAJT	19	80%	60%	60%	80%	60%	0%	80%	80%	80%	80%	66.0%
	20	80%	60%	80%	80%	60%	0%	80%	80%	80%	40%	64.0%
GJILANIT	19	71%	43%	43%	57%	57%	0%	0%	43%	71%	43%	42.8%
	20	86%	57%	71%	57%	57%	0%	0%	57%	57%	86%	52.9%
GJAKOVËS	19	100%	100%	100%	100%	67%	0%	67%	100%	100%	67%	80.1%
	20	100%	100%	100%	100%	67%	0%	67%	67%	100%	67%	76.7%
Nr. Komunave që kanë zbatuar procesin	2019	29	25	27	29	22	0	22	23	32	22	23
	2020	31	28	32	29	25	0	22	24	31	28	25
